

Statistikat e transportit

Maj 2017

Tiranë, më 27 Qershor 2017: Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në Maj 2017 është 0.4 milionë ton. Krahasuar me Maj 2016, ky tregues është rritur me 12,1 %.

Në pesëmujorin e parë 2017, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 1.6 milionë ton, duke u rritur me 7,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016.

Porti i Durrësit zë 89,7 %, të gjithë mallrave të ngarkuara/shkarkuara në të gjitha portet.

Volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë është 3,2 milionë ton-kilometër, duke u rritur 5 herë më shumë krahasuar me Maj 2016.

Në pesëmujorin e parë 2017, volumi i mallrave është 10 milionë ton-kilometër, duke u rritur 153,0 % në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2016.

Tab. 1 Volumi i ngarkim-shkarkimit të mallrave në porte, Maj 2017

000/ton

Periudha	Gjithsej	Durrës	Porte të tjerë
Maj - 2016	348	318	30
Maj - 2017	390	350	40
Ndryshimi vjetor (%)	12,1	10,1	33,3
Janar - Maj 2016	1.506	1.375	131
Janar - Maj 2017	1.621	1.493	128
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	7,6	8,6	-2,3

Tab. 2 Transporti i mallrave me hekurudhë, Maj 2017

Periudha	Volumi i mallrave 000/ tkm	Volumi i mallrave 000/ ton
Maj - 2016	596	4
Maj - 2017	3.200	23
Ndryshimi vjetor (%)	437,0	475,0
Janar - Maj 2016	3.965	34
Janar - Maj 2017	10.032	70
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	153,0	105,9

Në Maj 2017, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 182 ton, duke u rritur 12,3 %, në krahasim me Maj 2016.

Në pesëmujorin e parë të 2017 volumi i mallrave të transportuara është 725 ton, duke u rritur 5,7 %, krahasuar me njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab. 3 Transporti i mallrave dhe postës me ajër, Maj 2017

Periudha	Mallra ton	Posta ton
Maj - 2016	162	38
Maj - 2017	182	36
Ndryshimi vjetor (%)	12,3	-5,3
Janar - Maj 2016	686	207
Janar - Maj 2017	725	182
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	5,7	-12,1

Në transportin ajror janë kryer 1.822 fluturime, duke shënuar një rritje me 7,3 %, ndaj Maj 2016.

Në pesëmujorin e parë 2017, janë kryer 8.696 fluturime, duke u rritur me 6,7 %, krahasuar me njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab. 4 Treguesit e transportit ajror, Maj 2017

Periudha	Nunri i shoqërive ajrore	Numri i fluturimeve	Numri mbikalimeve
Maj - 2016	15	1.698	15.483
Maj - 2017	17	1.822	15.009
Ndryshimi vjetor (%)	13,3	7,3	-3,1
Janar - Maj 2016	15	8.152	51.371
Janar - Maj 2017	17	8.696	51.216
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	13,3	6,7	-0,3

Në Maj, numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore është 192.938, duke u rritur 19,1 %, krahasuar Maj 2016.

Në pesëmujorin e parë 2017, numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore është 890.742 duke u rritur me 21,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Transporti ajror i pasagjerëve gjatë kësaj periudhe zë peshën më të madhe me 71,2 % të totalit.

Tab. 5 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit, Maj 2017

Periudha	Transporti i pasagjerëve		
	Me hekurudhë	Me det	Me ajër
Maj - 2016	11.080	73.791	162.017
Maj - 2017	7.539	95.312	192.938
Ndryshimi vjetor (%)	-32,0	29,2	19,1
Janar - Maj 2016	45.630	302.619	733.968
Janar - Maj 2017	15.457	345.550	890.742
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	-66,1	14,2	21,4

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare është 95.312 persona, krahasuar me Maj 2016, ky tregues është rritur 29,2 %.

Gjatë pesëmujorit të parë të vitit 2017, numri i pasagjerëve që udhëtojnë në linjë detare është 345.550, duke u rritur me 14,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab. 6 Transporti i mallrave, 2007- 2016

000/ton

Vitet	Transporti hekurudhor i mallrave	Transporti detar i mallrave	Transporti ajror i mallrave dhe posta
2007	399	4.332	4
2008	355	4.705	3
2009	343	4.193	2
2010	403	4.170	2
2011	317	4.067	3
2012	142	3.984	2
2013	151	4.001	2
2014	338	4.067	2
2015	198	3.840	2
2016	76	3.756	2

Tab. 7 Transporti i pasagjerëve, 2007- 2016

000/pasagjerë

Vitet	Transporti hekurudhori	Transporti detar	Transporti ajror
2007	1.091	925	1.107
2008	822	1.080	1.260
2009	645	1.160	1.395
2010	430	1.120	1.537
2011	453	1.166	1.817
2012	448	1.101	1.665
2013	329	1.009	1.757
2014	187	1.095	1.810
2015	189	1.186	1.977
2016	69	1.289	2.139

Metodologji

Përkufizime:

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit tokësor, ajror dhe detar.

Transporti hekurudhor: Çdo lëvizje e mallrave dhe/pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

Transport detar: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

Transport ajror: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/reth-nesh/cilesia-statistikore.aspx> Politika e revizionimit statistikor.